

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.04.2024*

**5.04.2024
Ora 11:08**

RENDI I DITËS

**Projektvendim: “Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i raporteve
financiare të partive politike për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik
2022”.**

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj.**

Parti Politike: S’ka prezent!


Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Në seancën e sotme publike, kemi në rend dite, shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i raporteve financiare të partive politike për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022” dhe çështjen e mbartuar, projektvendimin “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Kristian Luigj Shkreli, kryetar bashkie në Bashkinë Vau-Dejës, Qarku Shkodër, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Atëherë, në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës!

Z. Y. Merkaj: Zoti Kryetar, dje në datën 4 prill jashtë orarit zyrtarit, ka ardhur një e-mail nga Organizata KRIIK e cila ka sjellë disa rekomandime për projektvendimin

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 5.04.2024*

në lidhje me gjetjet. Mendojmë se nuk kishim kohën e mjaftueshme për t'u konsultuar dhe për t'i parë këto rekomandime. Kërkojmë të shtyhet seanca.

Z. I. Celibashi: Meqenëse vetëm dje kanë mbërritur nga KRIIK komente dhe opinione në lidhje me gjetjet e raportit të auditimit e raportet financiare për partitë politike për të ardhura dhe shpenzime për vitin 2022, do ta shtyjmë për t'i dhënë më shumë kohë administratës për t'i vlerësuar këto mendime dhe opinione të kësaj organizate. Me këtë rast do të shtyjmë dhe pikën e dytë shqyrtimin sipas pikës 2 të rendit të ditës, pasi kemi një kërkesë nga pala e interesuar, për shkak të mungesës së kohës nga ana e tyre, nga momenti i njoftimit e deri më sot. Do t'i lemë të dyja në seancën... kur e kemi planifikuar? Po, ditën e martë në orën 12:00. Mirë, faleminderit, seanca mbyllet!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

